P

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA DURRËS**
**KËSHILLI BASHKIAK**

# VENDIM

Nr.86, datë 28.06.2021

## PËR
## DETAJIMIN E FONDEVE TË MIRATUARA ME VKB-NË NR.21, DATË 25.02.2021 PËR KATËR OBJEKTET E KONTRATËS ME OBJEKT "RIFORCIMIN E NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESAT (PALLAT), TË CILAT JANË KLASIFIKUAR SI OBJEKTE ME DËMTIME TË MËDHA STRUKTURORE OSE DËMTIME SHUMË TË RËNDA JOSTRUKTURORE DHE QË NUK DUHEN RINDËRTUAR NGA E PARA" ME NR. 533/10 PROT, DATË 10.02.2021, PA SJELL NDRYSHIME NË VLERËN E SAJ

Në zbatim të Ligjit Nr.139, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligjit Nr.68/2017,"Për financat e vetëqeverisjes vendore", Ligjit Nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjit Nr. 137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021" i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 935, datë 25.11.2020 "Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e riforcimit të njësive të banimit në ndërtesat (pallat) dhe banesave individuale, në Bashkitë Durrës dhe Lezhë", Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 21, datë 25.02.2021 si dhe sipas relacionit tekniko – ligjor të hartuar nga Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike, me propozim të Zëvëndëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë,

## KËSHILLI BASHKIAK
## VENDOSI:

1. Detajimin e fondeve të miratuara me Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.21, datë 25.02.2021, për katër objektet e Kontratës për Punë Publike në kuadër të proçesit të rindërtimit me objekt "Riforcimin e njësive të banimit në ndërtesat (pallat), të cilat janë klasifikuar si

objekte me dëmtime të mëdha strukturore ose dëmtime shumë të rënda jostrukturore dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para" nr. 533/10 prot, datë 10.02.2021" pa sjell ndryshime në vlerën e saj, sipas listës së mëposhtme :

| Objekti | Vlera sipas kontratës nr.533/10 prot | Detajimi i fondit për objekt |
|---|---|---|
| Përforcim godinë banimi dhe shërbimi 1, 8, 10, 11 kate me 1 kat nën tokë, në rr. "Vaso Pasha", nr.32, Njësia Administrative nr. 4, Durrës | 115.374.448 lekë | 138.387.482,47 lekë |
| Riparim i mureve, suvatimeve deri në 4 kate ( 1 kat dyqane + 3 kate banimi ) të objektit 4 – 6 kate + 1 kat nën tokë garazh, me adresë L.13, rr. "Pavarësia", rr. "Tano Banushi ", nr. 6, Njësia Administrative nr. 5, Durrës | 24.811.614,5 lekë | 29.767.585,95 lekë. |
| Godinë banimi dhe shërbimi 2, 8, 12 kat me 1 kat nën tokë, me adresë: Njësia Administrative nr. 2, L.6, rr. "Shoqëria Bashkimi " nr. 10, GIS 25410, Durrës | 94.383.075,20 lekë | 66.403.025,89 lekë |
| Godinë banimi 5 kat në lagjen nr. 13, rruga " Venecia ", Plazh, Durrës | 15.454.887 lekë | 15.454.887 lekë |
| **Vlera Totale** | **250.024.024 lekë** | **250.024.024 lekë** |

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike, Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria Ekonomike.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar).

**KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK**

**Ani Dyrmishi**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA DURRËS

**U shpall sot me datë 29.06.2021**

2

BASHKIA DURRËS
06/7/21 Nr. 7438/24 PROT

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**PREFEKTI I QARKUT DURRËS**

Nr. 461 prot. /14

Durrës, më 06.07.2021

**Lënda:** Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK**

**DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr. 86 datë 28.06.2021 Për detajimin e fondeve të miratuara me VKB-në nr.21, datë 25.02.2021 për katër objektet e kontratës me objekt "Riforcimin e njësive të banimit në ndërtesat (pallat), të cilat janë klasifikuar si objekte me dëmtime të mëdha strukturore ose dëmtime shumë të rënda jostrukturore dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para" me nr. 533/10 prot, datë 10.02.2021, pa sjell ndryshime në vlerën e saj.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI**

**ROLAND NASTO**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - PREFEKTI I QARKUT DURRËS